REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT

SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, RINISË ,TURIZMIT DHE DIASPORA

Nr 6865 *prot*

Datë 14.07 */2026*

RELACION

PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

"MBI MIRATIMIN E NUMRIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË (KVR) TË BASHKISË LUSHNJE"

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltar!

Këshilli Vendor i Rinisë është një strukturë këshillimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore,Bashkisë Lushnje , krijuar me qëllim garantimin e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave vendore që lidhen me rininë, si dhe nxitjen e dialogut ndërmjet të rinjve dhe institucioneve vendore.

Në zbatim të ligjit nr.75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025, Bashkia Lushnje më datë 02.04.2026 shpalli thirrjen publike për aplikime për anëtarë të Këshillit Vendor të Rinisë, duke garantuar transparencën, barazinë e mundësive dhe respektimin e kritereve ligjore për përzgjedhjen e kandidatëve. Kandidatët *për KVR*, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të paraqisnin interesin e tyre, në adresën: *Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit, Sektori i Zhvillimit Ekonomik Vendor, Rinisë , Turizmit dhe Diaspora*, brënda afatit 04.05.2026 .

Me Urdhrin nr. 102, datë 28.04.2026, u ngrit Komisioni i Përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, i cili shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe pas vlerësimit të plotësimit të kritereve ligjore dhe dokumentacionit përkatës, vendosi në mënyrë unanime për kandidatët që plotësonin kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit Vendor të Rinisë, në zbatim të ligjit nr.75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025 .

Sipas nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar, Këshilli Vendor i Rinisë duhet të përbëhet nga një numër anëtarësh që llogaritet në një të tretën e numrit në fuqi të anëtarëve të

Këshillit Bashkiak (41 anëtarë , Këshilli Bashkiak), ku të paktën dy të tretat e anëtarëve duhet të jenë të rinj të moshës 15–29 vjeç.

Në zbatim të këtij përcaktimi, Këshilli Vendor i Rinisë i Bashkisë Lushnjë do të përbëhet nga 14 (katërmbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve të paktën 10 (dhjetë) të rinj të përzgjedhur përmes thirrjes publike. Këshilli bashkëkryesohet nga Kryetari i Bashkisë, sipas përcaktimeve ligjore,në cilësinë e Kryetarit të KVR –së. Mandati i anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë është 2 (dy) vjeçar me të drejtë riemërimi. KVR mblidhet jo më pak se 4(katër) herë në vit dhe kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij.KVR do të mbështetet nga sekretariati teknik, i cili do të përzgjidhet në mbledhjen e parë të tij.

Duke qenë se procedura e përzgjedhjes është zhvilluar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke respektuar parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrimit të hapur, si dhe janë plotësuar kriteret ligjore për përbërjen e Këshillit Vendor të Rinisë, propozojmë që Këshilli Bashkiak Lushnje të miratojë numrin e anëtarëve (14 anëtarë) të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR) sipas listës bashkëlidhur projekt vendimit.

Sektori i Zhvillimit Ekonomik, Promovimit, Rinisë dhe Turizmit

Blerina Mebelli

2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 6965 prot
1

Datë 14/07/2026

PROJEKT VENDIM

NR. 65 DATË 14/07/2026

"MBI MIRATIMIN E NUMRIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË (KVR) TË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë: "Mbi miratimin e numrit të Anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR) të Bashkisë Lushnje",
Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, si dhe neni 54 si dhe Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025, Kreu II , neni 7, neni 10 , Këshilli Bashkiak Lushnje:

PROPOZON:

I) Të miratojë numrin e anëtarëve (14 anëtarë) të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR) sipas listës bashkëlidhur këtij projekt vendimi:

1.Eriselda Sefa

2.Aida Turku

3.Eljon Gorovelli

4. Kleopatra Çapari

5.Ervin Ferra

6. Pandora Silo

7. Albi Hida

8. Xhejsika Boriçi

9. Brajan Taullahu

10.Brisejda Divjaka

11. Hysni Topi

12.Ariena Silo

13. Marsida Ciku

14. Alisja Domazeti

II -Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit, Sektori i Zhvillimit Ekonomik, Rinisë ,Turizmit dhe Diaspora.

III- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sektori i Zhvillimit Ekonomik ,Rinisë,Turizmit dhe Diaspora

Blerina Mebelli

2026

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa